



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
MINISTRI

Nr. 3431 Prot.

Tiranë, më 03. 4. 2018

URDHËR

NR. 150, DATË 03. 4. 2018

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHURIN NR. 344, DATË 19.08.2013 "PËR  
NGRITJEN E NJËSISË SË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 20 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, VKM nr. 175, datë 08.03.2017 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar", i ndryshuar, të VKM nr. 505, datë 13.09.2017 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë",

URDHËROJ:

1. Shkronja "b" e pikës 5 e urdhrit nr. 344, datë 19.08.2013, ndryshon si më poshtë: "Në institucionet e arsimit të mesëm të lartë të sigurohet një psikolog dhe një punonjës social për 1800-2300 nxënës, ndërsa për çdo institucion të arsimit të mesëm të lartë të llojit gjimnaz me mbi 700 nxënës të sigurohet një psikolog ose një punonjës social.
2. Numri i punonjësve të shërbimit psiko-social që shtohen në zbatim të këtij urdhri, të bëhet brenda numrit të punonjësve mësimorë, të miratuar për vitin 2018 për çdo Drejtori Arsimore Rajonale dhe Zyrë Arsimore".
3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, njësitë arsimore vendore.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".



MINISTËR

*Lindita Nikolla*